

SHTRESA MITOLOGJIKE NË KËNGËT EPIKE LEGJENDARE SHQIPTARE, RASTI I EPOSIT TË KRESHNIKËVE

Rovena VATA-MIKELI¹

¹*Akademia e Studimeve Albanologjike, Tiranë*

Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë

Departamenti i Studimeve Letrare

Abstrakt

Mitologjia, në veçanësitë e saj të zanafillës, është një mesazh nga periudha të ndryshme të kohës së lashtë, por në rastin e hulumentit tonë është përdorur me kuptime të figurshme, për të tipizuar personazhe, për të shprehur idenë e forcës, të mençurisë, të trimërisë, për të shprehur ide dhe norma të ndryshme morale dhe juridike të shoqërisë së i mbart ato. Miti në krijimtarinë folklorike nuk është thjesht mit, por një lëndë me burim mitologjik, e shëndërruar, e cila ka marrë funksione poetike dhe një ngarkesë sociale që i shërben një aktualiteti historik të caktuar, aktualitet që është shumë larg nga kuptimi i mirëfilltë i vetë mitit. Ndryshe na paraqitet miti në epos dhe ndryshe na paraqitet, në rite dhe besime popullore, i cili ruan origjinalitetin në një masë të dukshme. Në këtë krijimtari ndeshet në dukuri dhe qenie të ndryshme mitologjike.

Fjalë kyçe: *Epos, Muji dhe Halili, Ora, Zanat, Mali, fuqia.*

Mitet dhe besimet popullore ndër shqiptarë kanë tërhequr në kohë të ndryshme vëmendjen e mbledhësve dhe studiuesve për vlerat që sjellin në përgjithësi, për hedhjen dritë mbi mjaft probleme, që lidhen me historinë e popullit tonë, me etnicitetin e tij, për lidhjet apo për veçoritë në raport me analoget e popujve të tjerë. Trashëgimitë në këto fusha janë të shumta dhe të larmishme. Ndër to gjejmë një pasuri figurash të qenieve të mbinatyrshe, që kanë lidhje me dukuri të nryshme të natyrës apo të jetës njerëzore (Xhagolli, Agron:2017).

Cikli i Kreshnikëve përbëhet nga një varg rapsodish, në të cilat tregohen bëmat e dy vëllezërve, Mujit dhe Halilit, si dhe të tridhjetë shokëve të tyre, të cilët quhen agallarët e Jutbinës. Ky cikël përbën patjetër pjesën më të bukur, më madhështore e më të vjetër të folklorit tonë.

Studiuesit mendojnë se lindja e këtij cikli, mund të jetë aty nga shekujt XI-XII. Në to flitet për ndeshjet e vazhdueshme për toka e kullota, që fiset shqiptare kanë kryer në ato shekuj me fiset sllave. Nuk është një luftë e shpallur, por një gjendje lufte e paprerë, një gjendje e shqetësuar për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirisë së vendit. Pikërisht në këto rapsodi, siç thotë Kadareja, “paraqiten njerëz të jashtëzakonshëm në ditë të jashtëzakonshme”.

Në Eposin e Kreshnikëve të këtij populli, në një qartësi mjaft të dallueshme, vërejmë të jenë të pranishme me shumicë: mbetëza mitesh, besimesh, ritualesh, dokesh e veprimesh etiko-morale e juridike, që na vijnë nga kohë shumë të hershme (Tirta, Mark: 2016).

Çdo gjë të cilën njeriu ia shton natyrës në formë të veprave dhe gjurmëve quhet kulturë. Elementet e kulturës nuk lindin rastësisht. Sistemi i besimit dhe moralit, që qëndron në themelin e strukturës shoqërore, i cili e çon njeriun t'i zgjedhë elementet kulturore, t'u japë formë dhe t' kahëzojë, i kufizon ato dhe e jep inspirimin e elementeve.

Thënë shkurt, sistemi i besimit dhe moralit i cili në kuadër të një kornize shpirtërore i gjeneron elementet kulturore quhet qytetërim (Ozakpënar, Jëllmaz:2009).

Eposi heroik legjendar është një prej monumenteve më të hershme të kulturës tradicionale të shqiptarëve. Ndryshe prej një shumice të epeve të popujve të tjerë të Gadishullit Ballkanik dhe më gjerë të Evropës, të cilët u dëshmuar me shkrim qëmoti, epopeja legjendare shqiptare ka vazhduar të qarkullojë si art gojor deri në fillim të shekullit 20-të. Kjo është arsyeja që rapsodët shqiptarë janë quajtur “homerikët e fundit” të Ballkanit (Sinani, Shaban:2011).

Këngët e Kreshnikëve këndohen vetëm në zonat veriore të Shqipërisë dhe në Kosovë, në zonat kufitare dhe është pikërisht për këtë, që disa i quajnë edhe këngët e kufirit.

Në epos ka një simbolikë ku shkrihen bashkë shtresime të ndryshme deri dhe ato prehistorike shprehur përmes elementeve të mitologjisë, të besimeve të një kohe të lashtë (Tirta, Mark:2007).

Karakteristikë e qartë e këtyre këngëve është fakti, që njerëzit dhe ngjarjet paraqiten të hiperbolizuar sin ë veprimet, në jetën dhe në mendimet e tyre, ku përzihen qenie përrallore, siç janë: *Orët e Malit*, *Shtojzavallet* etj. Tërë kjo i bën këto këngë, në të cilat siç e pamë ka diçka të vërtetë historike, të marrin trajtat e këngëve legjendare.

Gjinia krijuese e popullit në këngët e kreshnikëve ka derdhur fantazinë dhe imagjinatën, duke përshkruar bëmat legjendare të gërshetuar me elementet e mitologjisë (Drishti, Riza:1987).

Në Ciklin e Kreshnikëve shquhen për nga bukuria e tyre disa nga rapsoditë, siç janë “Martesa e Mujit”, “Martesa e Halilit”, “Muji e Behuri”, “Omeri i ri”, “Zuku Bajraktar”, “Deka e Omerit” “Ajkuja kjan Omerin”, “Martesa e plakut Qefanak” etj.

Kreshnikët nderonin ritet. Ata e respektonin ritualin në jetën e tyre të përditshme si edhe në jetën fetare. Ritualizmi zotëron me autoritet të plotë në jetën e tyre shoqërore dhe politike. Kreshnikët njihnin kultin e diellit, të sakrificës njerëzore, kalendarin e festave të motmotit, festën e Shëngjergjit, të ngjitjes në majat e maleve (Haxhihasani, Qemal:1993).

Mitologjia në hershmërinë e saj është një mesazh nga periudha të ndryshme të kohëve të lashta, po në studimin tonë është përdorur me kuptime të figurshme, për të tipizuar personazhe, për të shprehur idenë e forcës, të mëncurisë, të trimërisë, për të shprehur ide e norma të ndryshme morale e juridike të shoqërisë që i mbart ato.

Miti në krijimtarinë folklorike nuk është thjesht mit, por konsiderohet një lëndë me burim mitologjike, e shëndërruar, që ka marrë funksione poetike, si dhe një ngarkesë sociale për t'i shërbyer një aktualiteti historik të caktuar. Për më tepër, ndryshe na paraqitet miti në epos dhe ndryshe në rite e besime popullore, ku e ruan origjinalitetin në një masë të konsiderueshme.

Në këtë krijimtari ndeshesh në çdo hap në dukuri e qenie të ndryshe mitologjike, që shpeshherë kanë përfunduar në shprehje figurative letrare të një natyre realiste ose në rrëfime me përmbajtje përrallore.

Vetë natyra e kësaj epike, si krijim poetik që na vjen nga një kohë e herëshme kur mitologjia e besimet popullore kanë qenë shumë më të gjalla e vepruese në jetën e bashkësive fshatare (Tirta, Mark:2007).

Kështu, Muji del në beden të kullës, e duke futur gishtat në vesh thërret zanat vëllazërore (motrat) të vijnë për ta ndihmuar në ndeshje me kundërshtarët e tij. Zana vjen, hun në kullë, pi kafe dhe i thotë Mujit se nuk merr dot pjesë në ndeshje, ngaqë është lehonë, veç kësaj ka dhe dy binjakë të vegjël, të cilët nuk mund t'i lërë vetëm.

I kërkohet me këmbëngule të vijë në luftë vetëm sa për të qenë e pranishme atje, për t'u dhënë zemër kreshnikëve në ndeshje me armiqtë. Në vështrim të parë duket sikur ke të bësh me një grua të zakonshme, e cila shfaqet me hallet e saj, si nënë, si lëhonë. Së fundi shfaqet forca e saj demoniake.

Ora në besimet popullore paraqitet si një gjë e padukshme, përgjithësisht pa trup dhe pa formë, përveçse kur është shpeshherë na del një vajzë e vogël shumë e bukur: “Gja e vogël ora që po ishte, / si dy rrfë n’at ballë dy sy m’i kishte”.

Mitet në këngët epike legjendare shqiptare, rasti i Eposit të Kreshnikëve, i gjejmë në shtresa të ndryshme. Mitet në këtë epikë na dalin në shtresa të ndryshme. Për nga mënyra e përfshirjes, llojshmëria dhe vendi i tyre në strukturë të epeve, mitet mund t’i ndajmë në grupe:

Së pari, vërejmë dukuri mitologjike, njëfarëshe që përbëjnë bazën kryesore në trup të epeve, që janë nismë e tyre, themel, siç ndodh te epet: “Fuqia e Mujit”, “Muji dhe zanat”, “Murimi”, në kala a në urë, “Kostandini e Garentina”, “Met ni nanë me dy jetima”, “djali gjarpër”, “Mali i kuçedrës” etj.

Së dyti, kemi epe që mbarojnë me një mit të mirëfilltë ose me një formulë magjike. Të shkon mendja që edhe subjekti është thurur për të shpjeguar këtë mit a këtë magji: njeriu kthehet në dru, në qype ose ngjallet pasi ka vdekur. E tillë është kënga “Motra e Agës Hasan Agë”.

Së treti, ka subjekte të tilla, ku kemi komplekse mitesh me natyra të ndryshme, pra disa mite, prej të cilave nuk mund të caktosh me kryesorin e tyre. Secila dukuri mitologjike luan një rol të caktuar në një gjymtyrë të veçantë të epit. Këtë gjë e vërejmë te: “Martesa e Halilit”, “Halili merr gjakun e Mujit”, “Omeri i Ri”, e në një shumicë të subjekteve të kësaj epike.

Sipas studiuesit Mark Tirta i cili vë theksin se Martesa e Halilit përmban elemente mitologjike, genie mitike e të besimeve popullore nga më të ndryshmet (Tirta, Mark:2007).

Së katërti, vërejmë elemente të shkrira brenda krijimit poetik, që përfaqësohen ndoshta vetëm me emra, po që duket qartë se kemi të bëjmë në zanafillë me një mit, p.sh., zogjtë, hëna, dielli, ahu 300 vjeç, Gurra e Bardhë, që shoqërojnë veprimet e heronjve.

Këtë dukuri do ta gjejmë edhe në studimin e Mark Tirtës, kur shprehet: Në epos, na dalin shpesh herë objekte, vende e gjallesa kulti, që në mitologji e besime popullore pagane të shqiptarëve kanë një vend tepër të rëndësishëm si: Gurra e Bardhë, Logu i Bukur (logu i Zanave), Hëna, Dielli, Mrizi i Zanave, Ahu 300 vjeç, Bjeshkët e Diellit, Bjeshkët e Nemuna, gjarpri, qyqja, ujku etj (Tirta, Mark:2007).

Së pesti, kemi elemente ose struktura mitologjike që janë kryesisht të shndërruara, që kanë fituar funksione poetike, aktulizim historik, siç është “Gjergj Elez Alia”, “Në shpellë të kreshnikëve”. Këtu një lëndë e gjerë mitologjike ka shërbyer në dhënien e tipareve të disa figurave dhe të personazheve që veprojnë në epe të ndryshe të kësaj epike.

Shtresimi, sipas funksioneve të mirëfillta dhe vjetërsisë së elementeve, dukurive e figurave të ndryshme mitologjike krijon një përfytyrim më të qartë për kuadrin e përgjithshëm të vendit dhe të rolit të kësaj lënde në këtë krijimtari poetike, tregon sesi e ka ushqyer këtë art me tradita të lashtësisë, kur mitologjia në trojet ilire ka qenë e gjallë e vrpuese në jetën e banorëve vendas. Sipas vjetërsisë e funksioneve mund të shënojmë këto dallime:

a) Nga bota bimore e shtazore përdorën në funksione mitesh, si: lisi, ahu, bliri, dhia e egër, kali, pëllumbi, qyqja, zogu, bilbili, ujku, gjarprit etj.

Në ciklin e kreshnikëve është ora figurë mitologjike me veprim të dukshëm. Kjo i shoqëron kreshnikët në veprimet e tyre, u rri afër, i ndihmon. Herë-herë shndërrohet, duke marrë pamjen e gjarprit, po gjithnjë i bën të mira njeriut, kreshnikut (Tirta, Mark:2007).

b) Në kohën e matriarkatit, por edhe më vonë kanë marrë funksione të patriarkatit hyjnë, si: dielli, hëna e yje, vetëtima, bubullima, vende kulturi, si Majat e bjeshkëve, pylli a shpella e zanave, mризet e zanave, kroi i bardhë a gurrët e bardha, murana, ahu 300 vjeç e kështu me radhë.

Karakteristikë e qartë e këtyre këngëve është fakti, që njerëzit dhe ngjarjet paraqiten të hiperbolizuar si në veprimet, në jetën dhe në mendimet e tyre, ku përzihen qenie përrallore, siç janë: *Orët e Malit*, *Shtojzavallet* etj. Tërë kjo i bën këto këngë, në të cilat siç e pamë ka diçka të vërtetë historike, të marrin trajtat e këngëve legjendare.

Veçanërisht në ciklin e Veriut, qeniet mitologjike si orët, zanat, gjarpri mbrojtës e tjerë, u qëndrojnë shumë afër kreshnikëve, në shumë raste janë të shkrirë me veprimet e tyre; bëjnë disa herë një jetë familjare si edhe njerëzit (Tirta, Mark:2007).

c) Figurat mitologjike që përfaqësojnë në origjinë të tyre hyjni të ndryshme të lashtësisë janë të shumta, ku mund të përmendim, si: zanën, orën, dragoin, kuçedrën, etj, po edhe reminishencat e heronjve kulturorë të lashtësisë.

Një figurë mitologjike, me tipare që dallojnë qartë se janë me zanafillë nga lashtësia e që merr pjesë vepruese në subjekte të ndryshme të epikës legjendare e, në mënyrë të veçantë, në ciklin e Mujit e të Halilit, është zana (Tirta, Mark:1987).

Studiuesi Shaban Sinani në vë dukje fatin se Zana në epos është edhe nënë (Sinani, Shaban:2011).

Kreshnikët janë trima me fuqi mbinjerëzore. Ata e marrin fuqinë prej zanave, figura qendrore të mitologjisë shqiptare (Sinani:Shaban:2011).

BIBLIOGRAFIA

- [1]. Bihiku, Koço. (2004). *Krijimtaria letrare e Migjenit*, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Shtëpia Botuese “Mësonjëtorja”, Tiranë.
- [2]. Driшти, Riza. (1987). *Armët në ciklin e këngëve të kreshnikëve shqiptarë*, botuar në: “Çështje të Folklorit Shqiptar”, nr. 3, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë.
- [3]. Haxhihasani, Qemal. (1993). *Mendësi zotëruese në ciklin e kreshnikëve*, botim në revistën: “Gjurmime albanologjike”, Prishtinë.
- [4]. Ozakpënar, Jëllmaz. (2009). *Kultura dhe qytetërimi-një teori e qytetërimit*, Shtëpia Botuese “Logos-A”, Shkup-Prishtinë-Tiranë.
- [5]. Sinani, Shaban. (2011). *Mitologji në eposin e kreshnikëve*, Shtëpia Botuese “Naimi”, Tiranë, 2011.
- [6]. Tirta, Mark. (1987). *Shtresime mitologjike në epikën legjendare*, botuar në: “Çështje të Folklorit Shqiptar”, nr. 3, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë.
- [7]. Tirta, Mark. (2007). *Panteoni e simbolika-Doke e kode në etnokulturën shqiptare*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë.
- [8]. Tirta, Mark. (2016). *Kuptimësi të miteve dhe besimeve në Eposin e Kreshnikëve*, në: “Etnokultura shqiptare-ligji dokesor”, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë.
- [9]. Xhagolli, Agron. (2017). *Rrugëtim studimesh folkloristike*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Tiranë.